

VENDIM
Nr.344, datë 6.6.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT
RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153,
DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 1 e nenit 60, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Zonat e shërbimit, të caktuara për furnizimin ose për pushimin e përdoruesve të rrugës, janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, për arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura, me shpërndarës karburanti, ofiçina shërbimi (servise) dhe lavazhe, vende pushimi ose qëndrimi, mjedise shërbimi për udhëtarët, në nivel ose disnivel, kabina telefonike, pika të ndërhyrjes së shpejtë dhe të policisë rrugore, si dhe shërbime higjieno-sanitare, të përshtatshme.”.

1. Në pikën 4 të nenit 65, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, duhet të jenë të aftë, që, në bazë të normave të sigurimit, të mbajnë njëkohësisht edhe disa mjedise shërbimi, brenda të njëjtit kalim.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha